

UDC 37.035:502/504

Bujar Adili, MA¹⁶⁷

**PROCESI ARSIMOR DHE EDUKATIV NË FUNKSION TË
MBROJTJES DHE PËRPARIMIT TË MJEDISIT**

**ОБРАЗОВНО-ВОСПИТНИОТ ПРОЦЕС ВО ФУНКЦИЈА НА
ЗАШТИТАТА И НАПРЕДОКОТ НА СРЕДИНАТА**

**THE EDUCATIONAL PROCESS IN FUNCTION OF PROTECTION
AND PROGRESS OF THE ENVIRONMENT**

Abstract

The system of ecological education has a significant impact on the formation of ecological culture of contemporary man. The ecological education presents the understanding of the general problem of ecologization of material and spiritual activity in society. The wide range of the ecological education enables the inalienable synthesis of knowledge, skills and habits of natural and social sciences. The educational process in function of protection and progress of the environment represents a planned development of knowledge on the human environment throughout life, which aims to develop awareness of the fundamental characteristics of the human environment, the reports, according to which man will pretend to maintaining and progress the environment. The ecological education should provide highly secure knowledge on fundamental ecological issues of contemporary society, to develop a critical approach to increasing environmental degradation and highlights the need for rational use of natural resources. This paper treats the theoretical aspect of the implementation of environmental contents in all levels of the education system.

¹⁶⁷ Master in pedagogical sciences, the author is not yet engaged in any institution, e-mail: bujaradili74@gmail.com

Keywords: the education system, the ecological education, environment

Abstrakt

Sistemi i arsimit dhe edukimit ekologjik ka një ndikim të rëndësishëm në formimin e kulturës ekologjike të njeriut bashkëkohor. Arsimi ekologjik paraqet të kuptuarit e problemit të ekologjizimit të përgjithshëm të aktivitetit material dhe shpirtëror të shoqërisë. Diapazoni i gjerë i arsimit ekologjik mundëson sintezën e patjetërsueshme të dijeve, aftësive dhe shprehive nga shkencat natyrore dhe shoqërore. Procesi edukativ dhe arsimor në funksion të mbrojtjes dhe përparimit të mjedisit jetësor paraqet një zhvillim të ndërgjegjshëm dhe të planifikuar të dijeve mbi mjedisin njerëzor gjatë tërë jetës, që ka për qëllim zhvillimin e vetëdijes mbi karakteristikat themelore të mjedisit njerëzor, raporteve në të, në bazë të të cilave njeriu do të mëtojë në ruajtjen dhe përparimin e mjedisit. Arsimi ekologjik duhet të ofrojë dije tejet të sigurta mbi çështjet fundamentale ekologjike të shoqërisë bashkëkohore, të zhvillojë qëndrim kritik ndaj degradimit në rritje të mjedisit dhe të vë në pah nevojën e shfrytëzimit racional të resurseve natyrore. Ky punim trajton aspektin teorik të implementimit të përmbajtjeve ekologjike në të gjithë nivelet e sistemit të arsimit dhe edukimit.

Fjalë kyçe: sistemi arsimor, edukimi ekologjik, mjedisi

Hyrje

Ekologjia na mëson t'i duam të gjitha bimët dhe shtazët, natyrën rreth nesh. Çdo fëmijë që njihet me ekologjinë kurrë më s'do të shkel kullosën, nuk do të thyejë degët as do të zhdukë zogjtë. Ekologji është të mbrosh natyrën. Ekologjia – oikos, në gjuhën e vjetër greke do të thotë shtëpi, kurse logos do të thotë shkencë. Pra, ekologjia është shkencë mbi shtëpinë tonë – Planetin në të cilin jetojmë. Në fakt, ekologjia studion marrëdhëniet e qenieve të gjalla dhe mjedisit ku jetojnë si dhe raportet ndërmjet vetë qenieve të gjalla. Ekologjia, para së gjithash, është mënyra e jetesës.

Arsimi ekologjik nuk duhet të jetë vetëm informim mbi eko – faktet, prandaj programi i institucioneve arsimore duhet të jetë në përputhje me kërkesat ekologjike (Bogner, 1998). Vetëdija ekologjike nuk përbëhet vetëm nga dijet, por dhe nga komponenta emocionale të cilat janë shumë me rëndësi pasi dijet pa prova dhe aktivitet praktik nuk vlejnë shumë. Arsimi dhe edukimi ekologjik dhe formimi i mënyrës së të menduarit ekologjik fillon nga rinia më e hershme, prandaj është shumë me rëndësi që në mënyrë të drejtë të stimulohen fëmijët që nga moshat më të vogla. Ekologjia nuk është mjaftueshëm prezente në punën me fëmijë të moshave më të vogla kurse kompetenca e edukatorëve dhe arsimtarëve nga fusha e ekologjisë mund të jetë diskutabile.

Arsimi dhe edukimi ekologjik

Arsimi dhe edukimi ekologjik paraqitet si faktor i patjetërsueshëm i proceseve shoqërore duke përfshirë vlerat themelore ekologjike dhe dijet mbi sistemin edukativ dhe arsimor dhe në këtë mënyrë duke ndryshuar sjelljen e përgjithshme njerëzore për qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm. Pikërisht në baza të tilla mbështetet procesi i arsimit dhe edukimit për mbrojtje të mjedisit. Në thelbin e tij ky proces tenton nga hapsirat më të shëndosha jetësore dhe nga jeta e shëndetshme (Warburton, 2003).

Edukimi ekologjik do të duhej të bazohet në parimet globale, holistike dhe sistematike. Të kuptuarit e përgjegjësive personale të individëve të cilët me aktivitetet e tyre ndryshojnë mjedisin dhe transmetimi i këtyre dijeve te nxënësit është një nga detyrat më të rëndësishme të arsimit dhe edukimit ekologjik (Hastie dhe Siedentop, 1999). Prandaj detyrë e arsimit dhe edukimit ekologjik është nxënia e dijeve në mënyrë që gjeneratat që vijnë dhe të cilat janë në fazë të aktivitetit të zgjidhjes së problemeve lidhur me mjedisin, të kenë dije të sistematizuara mbi problemet bashkëkohore të mjedisit njerëzor, mbi karakterin dhe esencën e rrezikut të mjedisit të

rrezikuar; mbi mënyrën e mënjanimin të pasojave negative të baraspeshës së prishur ekologjike.

Arsimi ekologjik është pjesë përbërëse e sistemit edukativ dhe arsimor. Qëllimi i një arsimimi të këtillë është që njeriu të ruajë dhe përparojë mjedisin e vet ashtu që ai të bëhet pjesë përbërëse e jetës së tij, punës dhe ekzistencës biologjike. Përskaj kësaj, arsimimi ekologjik ka për detyrë që të ngrejë vetëdijen kritike të njerëzve mbi nevojën e ruajtjes dhe përparimit të mjedisit të shëndetshëm, të pastër, të dinjitetshëm për njeriun dhe t'i njohë me pasojat e zhvillimit teknologjik dhe ndikimit të pakontrolluar të zhvillimit të tillë në ekosistemet dhe shëndetin e njerëzve.

Që nga njeriu të pritët dhe kërkohet sjellje ekologjike, duhet që më parë të arsimohet, që mund të arrihet vetëm përmes futjes së përmbajtjeve ekologjike në të gjithë nivelet e sistemit arsimor dhe edukativ. Prandaj duhet qasur organizimit të mësimin me tematikë ekologjike nëpërmjet inovimit të planeve dhe programeve mësimore dhe futjen e përmbajtjeve të rregullta ekologjike si lëndë të veçanta dhe në kuadër të lëndëve të tjera.

Burimet e eko – dijeve

Arsimimi ekologjik kërkon burime të ndryshme të dijeve (Wideen, Mayer-Smith dhe Moon, 1998). Veçojmë këto burime:

- Realiteti i drejtpërdrejtë – nënkupton mjedisin konkret në të cilin ekziston nxënësi. Kjo është shtëpia familjare, çerdhja, shkolla, fakulteti, kazerma, mjedisi urban dhe rural;

- Materialet tekstuale – librat shkollor, publikimet beletristike, tregimet, romanet etj;

- Mjetet mësimore dhe modelet, preparatet, maketat, fotografitë, vizatimet, tabelat, grafikonet, videot etj. Këto zëvendësojnë realitetin e drejtpërdrejtë;

- Arsimitari si faktor i rëndësishëm në realizimin e qëllimeve dhe detyrave të arsimit ekologjik: bën përzgjedhjen e përmbajtjeve më-

simore, vlerëson aspektet ekologjike të materialit, organizon dhe udhëheq procesin e nxënies së dijeve, formimin e qëndrimeve dhe shprehive të nxënësve, organizon dhe kryen aktivitete jashtëmësimore dhe me veprimet e tij drejtpërdrejtë ndikon në personalitetin e nxënësit;

■ Shtypi, televizioni, interneti dhe mjete të tjera të informimit masiv angazhohen në fushën e informimit dhe aktivizimit të qytetarëve në mbrojtjen e mjedisit.

Shkolla është faktori themelor i edukimit dhe arsimimit ekologjik. Shkolla ofron mundësitë më të mëdha në ndërtimin e vetëdijes së nxënësve. Ajo ofron mundësi të rëndësishme për fitimin e dijeve të caktuara, por dhe për ndërtimin e shprehive të caktuara, për zhvillimin e vetëdijes ekologjike duke zhvilluar dashurinë dhe qasjen me përgjegjësi ndaj familjes dhe mjedisit.

Arsimi i detyruar fillon me Programin përgatitor parashkollor duke filluar nga Gjuha amtare, Njohja e natyrës dhe shoqërisë, e deri te Edukimi figurativ dhe muzikor. Me inkorporimin e ekopërmbytjeve në programet mësimore të lëndëve të caktuara, ata bëhen pjesë përbërëse e programit, pjesë e tyre e pandashme (Miličić dhe Trebaticki, 2011).

Natyra ambivalente e njeriut është burim i përhershëm i “mosdisiplinës” ekologjike, prandaj me edukim duhet filluar që nga institucionet parashkollore dhe të mbarohet me përfundimin e shkollimit dhe përsosjes pasdiplomike, duke lënë hapësirë për mundësinë e zbatimit të dijeve ekologjike në praktikë.

Ashtu siç është loja për fëmijën mënyrë e zhvillimit të aftësive kognitive, të mësuarit dhe njohjen e botës përreth, ashtu ajo mund dhe duhet të shfrytëzohet për zhvillimin e vetëdijes ekologjike (McLeroy, Bibeau, Steckler dhe Glanz, 1988). Kjo mund të bëhet nëpërmjet punëtorisë ekologjike në të cilën tema themelore duhet të jenë:

❖ Njohja e fëmijëve me nocionet siç janë: mbrojtja e mjedisit të njeriut, reciklimi, ushqimi i shëndetshëm, jeta e shëndetshme, mbrojtja e natyrës...;

❖ Zhvillimi i vetëdijes për pozitën e vet në kuadër të shoqërisë;

- ❖ Zhvillimi dhe adoptimi i shprehive për jetesë të shëndetshme;
- ❖ Zhvillimi dhe forcimi i vetëdijes ekologjike nëpërmjet përmbajtjeve të ndryshme;
- ❖ Njohja e fëmijëve me pasojat e sjelljes dëmtuese ndaj mjedisit;
- ❖ Njohja e fëmijëve me potencialet e mjedisit dhe rëndësinë e ruajtjes së mjedisit jetësor dhe të punës;
- ❖ Ndryshimi i sjelljes në të mirë të ruajtjes së shëndetit personal;
- ❖ Zbatimi praktik i dijeve themelore mbi ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit njerëzor.

Roli i arsimtarit në procesin e zhvillimit të vetëdijes ekologjike te nxënësit

Se çfarë rëndësie do t'u jepet përmbajtjeve ekologjike dhe a do të bëhet një korelacion ndërmjet lëndëve mësimore në vetë procesin mësimor dhe me përvojat dhe dijet e nxënësve, në masë të madhe varet nga afinitetet, trajnimi dhe kompetenca e arsimtarit (Oxfords advanced learners encyclopedic dictionary, 1989: 183).

Rolin e arsimtarit duhet kuptuar si nevojë për rolin e ndryshuar të arsimtarit dhe bërjen e orvatjeve që të vihet në pah stereotipi dhe të kuptojnë tendencat e reja e të miratohen strategji të reja të zhvillimit të vetëdijes ekologjike në procesin mësimor. Pranimi i strategjive të reja arsimore nga ana e institucionit arsimor dhe gatishmëria e arsimtarit për përsosje profesionale dhe ngritje të cilësisë së kompetencave, nënkupton metodën e qasjes aktive, participuese dhe empirike.

Hulumtimet kanë treguar se ekziston një lidhje e rëndësishme ndërmjet arsimimit të arsimtarit dhe zhvillimit të fëmijëve (Dozier, 1997). Përfundimi kryesor i këtyre hulumtimeve është se arsimtarët me arsim të lartë tregojnë efikasitet më të madh në punë. Është vërtetuar se arsimimi i përgjithshëm i arsimtarit dhe përgatitja e veçantë

e arsimtarit për një lëndë të caktuar janë parakushte të mira të cilësisë së punës edukative dhe arsimore. Arsimtarët me arsimim të lartë kanë interaksion më të përshtatshëm me fëmijët, u sigurojnë fëmijëve përvojë më të pasur kognitive dhe gjuhësore, por janë më pak autoritarë dhe kërkues ndaj fëmijëve. (Soleša, Grijak dhe Soleša, 2011).

Suzić (2004) rekomandon se në ç'mënyrë të sendërtohet sistemi edukativ dhe arsimor. Ai pohon se elemente të sendërtimit janë: aftësia e të mësuarit, kreativiteti, të menduarit kritik, demokracia, interaksioni, kooperativiteti, empatia, autonomia, motivacioni.

Arsimi ekologjik orvatet të lidh përvoja të ndryshme dhe qasje profesionale, mbështetet në shumanshmërinë individuale të menyrës së kujdesit dhe përjetimit, interesit dhe kompetencës duke respektuar qasje të ndryshme përmbajtësore dhe metodike dhe mënyra të përpunimit. E gjithë kjo çon në diskutim të asaj që është trend i zhvillimit të sotëm – çështja e zhvillimit global e funksional dhe të qëndrueshëm ndërmjet gjeneratave dhe përbrenda tyre, të raporteve globale në një hapsirë që dëshiron të përkufizohet si “fshat global” (Andevski, 2006).

Përfundim

Edhe përkaj asaj që ekologjia si lëndë e veçantë mësimore nuk është e përfaqësuar në sistemin e arsimit të detyrueshëm, ekziston një kontinuitet në mësimin e përmbajtjeve ekologjike që nga mosha parashkollore e deri në fund të arsimit të mesëm. Se sa do të jenë të përfaqësuara përmbajtjet mësimore ekologjike në lëndët zgjedhore, fakultative dhe aktivitetet e lira, shumë varet dhe nga afiniteti dhe interesimi i arsimtarëve të caktuar si dhe shkollës në tërësi.

Arsimi dhe edukimi ekologjik për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit duhet kuptuar si degë e shkencës e cila mund t'i stimulojë mendjet e reja rreth temave reale jetësore. Nxënësit duhet patjetër të përballen me problemet në ritje të botës dhe arsimimi i tyre ekologjik duhet të fillojë në shkollimin fillor dhe të vazhdojë në shkollë të mesme. Kjo do të ishte bazë për aftësimin e gjeneratave të reja se si

në situata konkrete do të dallonin zhvillimin nga ritja, të sëmurën dhe të shëndoshën. Kjo do të ishte baza e asaj që mund të emërohet si “inteligjencë e orientuar ekologjike”.

Arsimi dhe edukimi ekologjik për mbrojtjen e mjedisit duhet të mundësojë ridefinimin e qasjes së njeriut ndaj natyrës dhe ndryshimin e sjelljes së tij. Kushti kryesor është respektimi i ligjshmërive natyrore sepse natyra është burim i jetës që duhet ruajtur patjetër. E që ta arrijë këtë, njeriu nuk guxon të prish baraspeshën e saj, ndërvarshmërinë, llojllojshmërinë dhe fuqinë e vetreproduksionit.

Resume

Despite what ecology as a separate subject teaching is not represented in the mandatory education system, there is a continuity in the teaching of ecological contents since the preschool age to the end of secondary education. How much will be represented ecological teaching contents in electives and optional subjects and free activities, depends on certain teacher's affinity and interest and school in general.

The ecological education for the protection and improvement of the environment should be understood as a branch of science which can stimulate young minds about real life topics. Students must face the world growth problems and their ecological education should start in primary and continue in high school. This would be the basis for the training of new generations how to concrete situations would discern the development from growth, the sick and healed. This would be the basis of what can be named as "ecological oriented intelligence".

The ecological education for environmental protection should enable the redefinition of human approach to nature and change his behavior. The main condition is respect for natural legalities because the nature is the source of life that must be preserved. And to achieve this, the man must not ruin its balance, interdependence, diversity and the power of self reproduction.

Referencat

Andevski, M. (2006). Ekologija i održivi razvoj na putu ka društvu učenja. Novi Sad: Cekombooks.

Bogner, F. X. (1998). The influence of short-term outdoor ecology education on long-term variables of environmental perspective. *The Journal of Environmental Education*, 29(4), 17-29.

Dozier, K. (1997). Using Our National Diversity as an Educational Resource. *Social Studies*, 88,252-256.

Hastie, P., & Siedentop, D. (1999). An ecological perspective on physical education. *European Physical Education Review*, 5(1), 9-30.

McLeroy, K. R., Bibeau, D., Steckler, A., & Glanz, K. (1988). An ecological perspective on health promotion programs. *Health Education & Behavior*, 15(4), 351-377.

Miličić-Trebaticki, D. (2011). „Da nam čistije i zelenije bude – ekološke aktivnosti“. *Zbornik VŠSSOV*. Kikinda: Visoka škola strukovnih studija za obrazovanje vaspitača. god. VI, nr. 2. f. 133-142.

Oxfords advanced learners encyclopedic dictionary. (1989). Oxford University.

Soleša Grijak Đ., Soleša, D. (2011). „Kompetentnost predškolskih vaspitača za društvo učenja“. *Pedagogija*, 648- 655.

Suzić, N. (2004). „Naša škola u odnosu na kompetencije za XXI vijek“. Novi Sad: *Pedagoška stvarnost*, nr. 3-4.

Warburton, K. (2003). Deep learning and education for sustainability. *International Journal of Sustainability in Higher Education*, 4(1), 44-56.

Wideen, M., Mayer-Smith, J., & Moon, B. (1998). A critical analysis of the research on learning to teach: Making the case for an ecological perspective on inquiry. *Review of educational research*, 68(2), 130-178.